REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, LEGJISLACIONIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr.3022/4 Prot. Patos, më 24/09/ 2026

NJOFTIM

Dëgjesë publike me temë:
"Prezantimi përfundimtar i Paketës Fiskale 2027"

Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB nr. 83, datë 17.12.2025 "Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2027-2029 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2027".

Ju njoftojmë se:

Ditën e **Martë** në datë **27.10.2026 ora 10:00**, në njësinë administrative Ruzhdie do të organizohet dëgjesa publike me përfaqësues të: anëtarë të Këshillit Bashkiak; kryetarë të fshatrave; banorë të njësive administrative; shoqëri civile; biznese të bashkisë Patos, përfaqësues të bashkisë Patos dhe grupe të tjera interesi; me temë: **"Prezantimi përfundimtar i Paketës Fiskale 2027".**

Ky konsultim publik synon realizimin e një procesi transparent mbi prezantimin e dokumentit final të Paketës Fiskale 2027 në të tre njësitë administrative të bashkisë Patos.

Komentet dhe rekomandimet e grupeve të interesit janë të mirëpritura, brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik në adresën e email-it: info@bashkiapatos.gov.al.

Pjesëmarrja juaj në këtë dëgjesë publike është shumë e rëndësishme për garantimin e një procesi sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.

KRYETARI
Fation Duro